



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 113, datë 28.06.2024

PËR

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË EMRIT TË FONDIT TË PENSIONIT VULLNETAR
“SIGAL PRO”**

**MIRATIMIN E KONTRATAVE TIP TË ANËTARËSIMIT NË FONDIN E PENSIONIT
PRIVAT ME PJESËMARRJE TË HAPUR, SI DHE DEKLARATËS TIP TË PRANIMIT
TË PJESËMARRJES SË PUNËMARRËSIT NË FONDIN ME PJESËMARRJE TË
HAPUR TË PËRZGJEDHUR NGA PUNËDHËNËSI**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22 e ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, dhe rregullores nr. 2, datë 31.01.2024 “Për përcaktimin e elementëve të kontratës së anëtarësimit, të deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes, të kontratës së administrimit të aktiveve të shoqërisë administruese dhe përmbajtjes e strukturës së prospektit të fondit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e ndryshimit të emrit të Fondit të Pensionit Vullnetar “Sigal Pro”, në “Fond Pensioni Privat me pjesëmarrje të hapur Sigal Pro” dhe miratimin e kontratës tip individuale për anëtarësimin në fondin e pensionit privat me pjesëmarrje të hapur; kontratës tip midis punëdhënësit dhe shoqërisë administruese për anëtarësimin e punëmarrësve të tij në fondin me pjesëmarrje të hapur; deklaratës tip të pranimit të pjesëmarrjes së punëmarrësit në fondin me pjesëmarrje të hapur të përzgjedhur nga punëdhënësi.**
- 2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Mimoza KAÇI